



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2019:165306
Datë: 25.01.2024
Numri i dokumentit: 05237122

C.nr.355/2016

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Nazmi Neziri, dhe procesmbajtësen Afërdita Ejupi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. H. nga fshati O., Komuna e Podujevës, kundër të paditurës Komuna e Podujevës nga Podujeva, Rruga “N. G.” pn., të cilën e përfaqëson përfaqësuesi për konteste juridike F. R., me autorizim, me objekt kontesti Vërtetimin e pronësisë, me vlerë të kontestit: 3,100.00 Euro, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur me datën 20.12.2023, në prani të palëve ndërgjyqëse, të autorizuarës së paditësit dhe të autorizuarit të paditurës, ndërsa me datën 10.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësit A. H. nga fshati O., Komuna e Podujevës, **si e pabazuar**, me të cilën ka kërkuar që:

“1. Aprovohet kërkesëpadia e paditësit A. H. nga O. dhe vërtetohet se është pronar i palujtshmërive të evidentuara në fletëposedimin nr... ZK O.n: parcela katastrale ../.. në vendin e quajtur “m. e gj.”, arë e klasës së ... në sipërfaqe prej 0.16,00ha: parcelës kadastrale ../.. në vendin e quajtur “sh.-o.” në sipërfaqe prej 0.08,85ha; kullosa e klasë së tretë në sipërfaqe prej 0.36,95; arë e klasë së 7 në sip. prej 0,45,95ha; arë e klasës së VII në sip. Prej 0.97,30 ha; parcela kadastrale 12/12 arë e klasë së 7 në sip. Prej 0.62.99ha dhe parcela kadastrale nr.../... arë e klasës së 7 në sip. Prej 0.48,68 ha, në afat prej 15 ditësh prej ditës së plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

2. Drejtoria për kadastër pas plotfuqishmërisë të aktgjykimit do ti bartë palujtshmërit në emër të paditësit.

3. Obligohet e paditura që ti kompensoj shpenzimet e procedurës aq sa do të shkaktohen, në afat prej 15 ditësh, prej ditës së plotfuqishmërisë së aktgjykimit.”

Secili palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

I autorizuari i paditësit, ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadija dhe të vërtetohet se paditësi është pronar i paluajtshmërisë të përshkruar si në dispozitiv.

Ka shtuar se mbetem pranë padisë dhe kërkesëpadiisë, e kundërshtoj në tërësi përgjigjen në padi si të pa bazuar. Nuk është kontestues se prona që është objekt shqyrtimi është ekspropriuar për nevojat e liqenit të B., mirëpo prona në fjalë nuk është kompensuar e as që i është zëvendësuar me ndonjë pronë tjetër. Ka theksuar se qëndrojmë pranë padisë dhe parashtresës për propozimin e mjeteve provuese dhe precizimin në bazë të padisë. Në rastin Konkret nuk janë zbatuar rregullat e ligjit të aplikueshëm i cili është ligji në bazë të shpronësimit i dt.04.04.1947 me numër .../... i cili aplikohet në këtë rast e jo ligji i viteve të 70 mbi shpronësimin. Sipas neneve të këtij ligji 17 deri në nenin 33 vendimet përfundimtare të shpronësimeve bëhen nga Gjykata e Qarkut kompetent. Nëse analizohet vendimi numër 2478/61 si dhe dosja e çështjeve të shpronësimit sipas të njëjtit numër vërtetohen dy fakte me rëndësi se vendimi në atë kohë kur ishte marrur duke i referuar kalendarit në të cilin është marrë vendimi i bie i të jetë e Shtunë dhe e Diele të dy vendimeve të datës 15.07.1961 dhe 23.07.1961, për çka këto vendime rrjedhimisht nuk ka arritur dhe nuk është bërë i formës së prerë për kompensimin adekuat të shpronësimit. Në këtë kuptim pala e paditur ka bërë ndërhyrje në pronë në kundërshtim me protokollin 1 të Konventës Evropiane e që vërtetohet dhe nënkuptojmë se shpronësimi është bërë në mënyrë të kundërshtimit të ligjeve në fuqi dhe pa kompensim adekuat. Rrjedhimisht pala e paditur është pasuruar pa bazë dhe pala paditëse është varfëruar.

Më tej ka shtuar se sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës së Strasburgut (të rastit të M. kundër G.), procedura e kompensimit adekuat duhet të bëhet me ndërhyrjen e shtetit në pronat private në atë formë që kjo ndërhyrje të jetë e ligjshme proporcionalisht dhe adekuate.

Përtej kësaj edhe në parashtresën e precizimit të padisë, është përcaktuar fakti tjetër vërtetohet se shpronësimi sipas vendimit numër ... i dt.15.07.2061 dhe dt.23.07.1961 ishte i kundërligjshëm si me ligjet dhe me kushtetutën, ashtu që në emër të pasurimit të pa bazë, si rrjedhojë shpronësimi nuk është i plotfuqishëm. Vërtetimi i së drejtë së shfrytëzimit të përhershëm të palës paditëse në parcelën lëndore në bazë të ndërtimit në pronën publike. Po ashtu vërtetimi i pronësisë i palës paditëse në parcelën lëndore në bazë të parashkrimit fitues.

Paditësi mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadiisë, precizimit të kërkesëpadiisë dhe gjitha deklarimeve të dhëna, duke konsideruar se nga provat e administruara është krijuar baza e mjaftueshme për aprovimin e tërësishëm të kërkesëpadiisë, pasi që nga provat e administruara vërtetohet se baza juridike është jokontestuese por dhe nga provat e administruara vërtetohet në tërësi se paditësi si trashëgimtar i të ndjerit E. H. është pronar i ngastrave kadastrale/... ,/... , dhe/... që shtrihen në Z.K. O. Komuna e Podujevës e që tani udhëhiqen në emër të të paditurës me numër ...-0, ...-0, ...-0, ...-0, ...-0, ...-0 dhe ...-0.

Ka theksuar se sipas Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore, numër 827, të datës 30 Janar 1980 (në vazhdim: LMTHJP), ligj ky i aplikueshëm në rastin konkret për shkak se raporti material juridik ka lindur gjatë kohës sa ky ligj ka qenë në fuqi, me nenin 3 është paraparë se: “Pronari ka të drejtë që sendin e vet ta mbajë, ta shfrytëzojë dhe ta disponojë në kufijtë e caktuara me ligj”, ndërsa me nenin 8 të po këtij ligji, është paraparë se: “E drejta e pronësisë mund të merret Ose të kufizohet vetëm në kushtet e përcaktuara me ligj në pajtim me

kushtetutën”. Edhe me dispozitat e Ligjit për Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, sidomos me nenin 18 par.1 është paraparë se: “Pronësia është e drejtë e tërësishme në një send. Pronari mund të disponoj me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedoj dhe përdorë, me atë të disponoj dhe të tjetër t’i përjashtoj nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti”.

Në kuptim të kësaj paditësi gëzon të drejtën e njohjes së pronësisë, pasi që i njëjti asnjëherë nuk i janë kompensuar e që e paditura ka pas obligim që të kujdeset dhe që ti marrin parasysh të drejtat dhe interesat e paditësit dhe të drejtat e tyre t’i ushtrojnë ashtu që të mos cenohen apo dëmtohen të drejtat paditësit, e që në rastin konkret kjo e drejtë ju jep paditësve të drejtën e kthimit të pronës në pronësi të vet konform dispozitave në fuqi.

Andaj, nga arsyet e cekura i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e precizuar të paditësit, si dhe të obligohet e paditura që ti paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të shpenzimeve për ekspertizë të gjeodezisë, taksat gjyqësore, si dhe për përpilimin e padisë shumë prej 208 euro dhe për pjesëmarrjen për çdo seancë shumë prej 270 euro dhe shpenzimet tjera të krijuara sipas tarifës e OAK, të gjitha në afat prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

E paditura nëpërmes përfaqësuesit të saj në përgjigje në padi, në përgjigje në padi dhe seancë e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, si për nga baza ashtu dhe lartësinë e saj. Më tej ka shtuar se mbetem në tërësi pranë përgjigjes në padi duke e kontestuar në tërësi pandë dhe kërkesëpadinë paditësit për arsye se palcëtat ../., ../., ../., janë ekspropriuar me Aktvendimin numër ../61 dt.23.07.1961, këto nga tani evidentohen prone e Komunës, konsiderojmë se paditësi duhet ta potencoj bazën juridike në të cilin kërkon që të njihet e drejta e pronësi në këto nga tani, nga se me ligjin mbi eksproprijim të vitin 1978 janë paraparë afatet për paraqitjen e anakëve e kundër aktvendimit për eksproprijim po ashtu me ligjin e punës së bashkuar përkatësin me nenit 226, është paraparë afati për kthimin e sendit e cila ka kaluar në pronën shoqërore, po ashtu edhe me ligjin mbi token bujqësorë si dhe me nenin 29 të ligjit mbi marrëdhëniet juridiko pronësore. Në qoftes e paditësi pretendon se nuk i është bërë kompensimi për ngastrat e eksproprijuara këtë çështje fillimisht duhet ta ndjek në çështje administrative, po ashtu kjo çështje konsiderojmë se është res judicata, prandaj edhe njëherë i propozojmë gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar.

Ka shtuar më tej se mbetem në tërësi pranë përgjigjes në padi. Konsiderojmë se kemi të bëjmë me çështje të gjykuar apo res judicata, ngase kjo çështje është vendosur me Aktgjykimet e ish Gjykatës Komunale në Podujeve me numër C.nr.45/2001, me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut me numër Ac.nr.262/2004 dhe Revizionin e Gjykatës Supreme Rev.nr.50/2008.

E kundërshtojmë zgjerimin e padisë ngase i theksuam kemi të bëjmë me çështjen e gjykuar për pretendimet tjera mund të ngrit padi tjetër e jo me këtë padi. Nga ekspertiza e ekspertit dhe nga vendimet e Korporatës Energjetike të Kosovës shihet se ngastrat e paditësit janë ekspropriuar dhe janë paguar. Për të gjitha pretendimet që i ngriti përfaqësuesja e paditësit e ka pas afatin ligjor për të parashtruar pretendimet e saj e jo tani pas 60 viteve.

Andaj, i ka propozuar gjykatës që në bazë të provave të afuara padinë dhe kërkesëpadinë e për vërtetimin e pronësisë paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova: u lexua Aktvendimi numër .../61 dt.23.07.1961 në gjuhën Serbe i dt.23.07.2061 së bashku me listën e bashkangjitur, Skica e Parcelës, Ekstrakti nga Fleta Poseduese numër ... dt.13.07.2016, Fleta Poseduese numër 13, në gjuhën serbe, lëshuar nga NOO O., Aktvendim i gjykatës Komunale në Podujevë me numër T.nr.107/2003 dt.29.08.2003, Parashtrësë e paditësit për vërtetimin e pronësisë dt.29.08.2016, Propozim për caktimin e masës së sigurisë dt.10.07.2017, Aktvendimi për plotësimin e padisë C.nr.355/16, dt.17.07.217, Plotësimi të masës së sigurisë dt.10.07.2017, Aktvendim me të cilin ftohet ta bëjë rregullimin e propozimit dt.17.07.2017, Plotësimi i masës së sigurisë për sigurimin e kërkesëpadisë dt.01.08.2017, Kërkesë për dhënie të Lokalit Afaristë – Restoranti “M..” në O., drejtuar Kuvendit Komunal në Podujevë, Aktvendim i kësaj gjykate me numër C.nr.355/16 dt.07.08.2017 me të cilin Refuzohet si i pa bazuar propozimi për caktimin e masës së sigurisë, Përgjigje në padi e dt.24.08.2020, Padi e hartuar dt.10.04.2001, Fleta Poseduese numër/2021 dt.20.03.2001, Procesverbal mbi shqyrtimin kryesor me numër C.nr.45/2001 dt.19.09.2001, Aktvendim i Gjykatës Komunale në Podujevë numër C.nr.45/2001 dt.29.09.2002, Fletë posedimi ZK O. numër .. numër 181, Ekspertizë e hartuar nga eksperti Sh. M. numër C.nr.45/2001 dt.04.10.2001, Kopja e Planit për fletën poseduese numër 181, Procesverbal mbi shqyrtimin kryesor me numër C.nr.45/2001 i dt.05.10.2001, Procesverbal mbi shqyrtimin kryesor me numër C.nr.45/2001 i dt.05.09.2001, Aktgjykim Refuzohet me numër C.nr.45/2001 dt.05.09.2002, Ankesë e paditësit numër C.nr.45/2001, dt.26.05.2004, Aktgjykim Refuzohet i Gjykatës së Qarkut numër Ac.nr.262/2004 dt.23.05.2007, Revizion i paditësit C.nr.45/2001, Aktgjykim i Gjykatës Supreme Refuzohet numër Rev.nr.50/2008 dt.15.10.2010, Certifikata e pronësisë numër P dt.18.08.2020, Certifikata e pronësisë numër P-... dt.18.08.2020, Certifikata e pronësisë numër P-.... dt.18.08.2020, Certifikata e pronësisë numër P-....-0 dt.18.08.2020, Procesverbal i numër C.nr.355/16 i dt.23.09.2021, Procesverbal i vendit të ngjarjes dt.22.11.2021, Ekspertizë nga lëmia e Gjeodezisë dt.23.12.2022 e hartuar nga ekspert Petrit Islami, Kërkesë e kësaj Gjykate nga Komuna e Podujevës dt.07.10.2023, Përgjigje në kërkesën e komunës dt.13.03.2023, Urgjencë e kësaj gjykate drejtuar Komunës së Podujevës për përgjigje në kërkesën për Historiat të ngastrës kadastrale dt.30.06.2023, dt.04.08.2023, dt.30.08.2023, Përgjigje nga Komuna e Podujevës dt.10.08.2023, përgjigja e gjykatës në parashtrësë e Komunës së Podujevës e dt.30.08.2023, Historiati i njërive kadastrale lëshuar nga Komuna e Podujevës dt.25.09.2023 e hartuar nga Komuna e Podujevës, Certifikata e dt.04.09.2023, për ngastrat Komunës bashkangjitur historiatit, Procesverbal i dt.05.10.2023, parashtrësë e të autorizuarit të paditësit dt.18.10.2023, parashtrësë për precizimin e padisë dt.12.12.2023, parashtrësë për plotësimin e precizimit të padisë e dt.05.12.2023, kërkesë – parashtrësë e dt.23.10.2023.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i LPK-së, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Pas deklarimit të palëve ndërgjygjëse thënieve në padi dhe përgjigjes në padi, daljes në vend shikim me ekspertin e gjeodezisë, si dhe deklarimit të palëve në seancat e shqyrtimit gjyqësor,

vlerësimi të provave në shkresat e lëndës si dhe dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-së), pasi që pala e paditur është thirrur se në rastin konkret kemi të bëjmë me çështje të gjykuar të kërkesëpadi së paditësit, duke kontestuar kështu bazën juridike.

Gjykata konform dispozitës së nenit 320 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-së), i cili ka përcaktuar se: “Gjykata është e autorizuar që t’i marrë edhe provat që nuk i kanë propozuar palët, po që se konstaton se ato tentojnë të disponojnë me kërkesat me të cilat nuk kanë të drejtë të disponojnë (neni 3 paragrafi 3 i këtij ligji).”, sipas detyrës zyrtare ka vendosur në shkresat e lëndës C.nr.355/2016 (U2019:165306), të cilat dhe i ka administruar si provë në procedurën e provës, kopjen e shkresave të lëndës C.nr.45/2021, e cila është vendosur dhe arkivuar nga ish Gjykata Komunale në Podujevë, me qëllim të vërtetimit dhe vlerësimit sa më të drejtë e më të saktë të gjendje faktike të çështjes së ngritur me padi.

Gjykata i vlerësoj pretendimet e palës paditëse dhe kundërshtimet e të paditurës dhe erdhi në përfundim se në rastin konkret kemi të bëjmë me çështje të gjykuar (res judicata) të çështjes së ngritur me padi-kërkesës së saj për sa i përket parcelave kadastrale të cilat tani mbajnë numrat e tyre 1339-0 dhe 1341-0, ku parcela 1341-0 është ndarë në njësitë kadastrale 1341-1 dhe 1341-2 në bazë të fletëparaqitjeve nr.19/2003 (ish ngastra 12/1), për këto arsye:

Gjykata gjatë shqyrtimit të padisë, pretendimeve të dhëna në padi dhe në të përgjigjur në padi, deklarimi të palëve në seanca si dhe daljes në vendin e ngjarjes me ekspertin e gjeodezisë dhe nxjerrjes së provës me anë të ekspertizës së gjeodezisë dhe historiatit të siguruar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë e Komunës së Podujevës, shqyrtimit dhe vlerësimit të të gjitha provave në shkresat e lëndës e të administruara në procedurën e të provuarit, si dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare nëse është në zhvillim e sipër gjykimi tjetër për të njëjtën kërkesëpadi midis palëve të njëjta, gjeti se kërkesa e paditësit për sa i përket vërtetimit të pronësisë në ngastrat kadastrale nr.-0 dhe-0, ku parcela-0 është ndarë në njësitë kadastrale-1 dhe-2 në bazë të fletëparaqitjeve nr..../2003 (ish ngastra .../1), është shqyrtuar dhe vendosur në mënyrë meritore nga ish Gjykata Komunale në Podujevë, kjo sipas Aktgjykimit C.nr.45/2001 i datës 05.09.2002, me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadi e paditësit, e i cili Aktgjykim tanimë ka marrë formën e prerë në bazë të Aktgjykimit të ish Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.262/2004 të datës 23.05.2007, të cilat vendime janë konfirmuar dhe vërtetuar tanimë edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin e saj Rev.nr.50/2008 të datës 15.10.2010.

Andaj, paditësit ju refuzua kërkesa për vërtetimin e pronësisë në këto ngastra kontestuese si e pa bazuar, për shkak se çështja e ngritur me padi tani përbënë çështje të gjykuar (res judicata) dhe si e tillë kjo çështje juridike, tani është jolëndore.

Me nenin 166 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-së), në paragrafin 2 është përcaktuar se: “Gjykata gjatë gjithë procedimit të çështjes kujdeset sipas detyrës zyrtare se a mos është e gjykuar çështja e ngritur me padi dhe nëse konstaton se procedura e iniciuar për kërkesën për të cilën ekziston vendimi i formës së prerë, padia duhet të hedhet poshtë si e palejueshme”.

Përkundër, asaj se në aktgjykimet e cituara më lartë, konkretisht Aktgjykimet të ish Gjykata Komonale në Podujevë, C.nr.45/2001 të datës 05.09.2002 saktësisht në dispozitivin e tij është vendosur lidhur me kërkesën e paditësit për njohjen e së drejtës së pronësisë në patundshmërinë e evidentuar në fletën poseduese nr.... në O., ngastra kadastrale nr..../1, vendi i quajtur “L. e Gj.” në O., me kulturë arë, në sipërfaqe prej 00.45.00 ha.

Ndërsa, tani në çështjen e ngritur me padinë e paditësit për të cilën është zhvilluar procedura kontestimore dhe është mbajtur shqyrtimi gjyqësor, me të cilën paditësi kërkon vërtetimin e pronësisë në ngastrat kadastrale si në dispozitiv nr.,, dhe që shtrihen në Z.K. O.. Komuna e Podujevës, të cilat tani janë të regjistruara-evidentuara në emër të të paditurës me numër-0,-0,-0 dhe ...-0, ku parcela ...-0 është ndarë në njësitë kadastrale-1 dhe-2.

Gjykata ka vërtetuar dhe ardhur në përfundim se kemi të bëjmë me çështje të gjykuar për kërkesën e paditësit për njohjen e së drejtës së pronësisë në parcelat të cilat sipas tani gjendjes së fundit të konfirmuar nga historiat i siguruar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë e Komunës së Podujevës, evidentohen me numrat e tyre të njëjësive-parcelave-0 dhe-0, ku parcela-0 është ndarë në njësitë kadastrale-1 dhe-2.

Pas një gjendje të tillë të konstatuar gjykata shqyrtoi dhe pretendimet dhe kundërshtimet tjera të palëve ndërgjyqjese dhe erdhi në përfundim (për ngastrat kontestuese ...-0 dhe ...-0) se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, dhe për këto arsye:

Është jokontestuese për gjykatën dhe palët fakti se ngastrat kontestuese gjenden në fshatin Orllan, Komuna e Podujevës, të cilat ngastra tani evidentohen në emër të paditurës Komuna e Podujevës si pronar i regjistruar, por kjo vërtetohet dhe me provat materiale në shkresat e lëndës siç janë Fleta poseduese nr.181 datë 13.07.2016, Historiat i njëjësive kadastrale Referencë nr.08-.../23 datë 05.09.2023 dhe Çertifikata mbi të drejtat pronësore bashkangjitur historiatit për njësitë kadastrale nr.....-2,-1, ...-0, ...-0,-0.

Ky fakt është i pa kontestuar nga palët ndërgjyqjese dhe provat tjera materiale që gjenden në shkresat e lëndës.

Një gjendje të tillë faktike, gjykata e ka vërtetuar në bazë të konstatimit dhe mendimit të ekspertit të gjeodezisë Petrit Islami nga Podujeva, të datës 23.12.2022, ku sipas konstatimit dhe mendimit të tij, sipas elaboratit të zyrës kadastrale në Podujevë të datës 15.09.2022, parcelat kadastrale gjenden në Podujevë gjegjësisht Zona kadastrale O., parcelat me numrin kadastral-0, me sipërfaqe 481 m², me kulturë shtëpi, oborr, kullosë,-0 me sipërfaqe 210 m², me kulturë arë 6, 13-07 me sipërfaqe 8715 m², me kulturë kullosë 3 dhe 4 dhe ...-0 me sipërfaqe 5465 m², me kulturë mal 4.

Parcelat me numrin kadastral-0, me sipërfaqe 1704 m², me kulturë e pa kategorizuar,-0 me sipërfaqe 1230 m², me kulturë tokë jopjellore,-0 me sipërfaqe 210 m², me luture shtëpi-oborr dhe-1 me sipërfaqe 2640 m², me kulturë tokë jopjellore dhe-2 me sipërfaqe 940 m², me kulturë shtëpi-oborr.

Në këto parcela-0,-0,-0 dhe-0, janë të paraqitura objekte të ndryshme.

Gjithashtu kjo gjendje faktike është vërtetuar dhe me rastin e daljes dhe këqyrjes në vend ngjarje të gjykatës, së bashku me palët ndërgjygjëse dhe ekspertin e gjeodezisë, ku është konstatuar se në paluajtshmërinë-ngastrat kontestuese janë të ndërtuara 5 objekte, prej të cilave një objekt është i ndërtuar ngjitur me rrugën kryesore në drejtim të O.. në të cilën ushtrohet veprimtari hoteliere, gjithashtu në rrugën kryesore është e ndërtuar objekti ku gjendet Posta e Kosovës ku ushtron veprimtarin e saj, ndërsa objekti i ndërtuar për destinim për Qendër rekreative prej rrugës kryesore që shtrihet me dalje në rrugën kryesore deri te bazeni akumulues i liqenit, ndërsa në fund të parcelës ngjitur me liqenin është objekti i cili ushtron veprimtarin hotelieri konkretisht restoranti M.. ku afër saj është edhe nja objekt shtëpi e cila shfrytëzohet për banim në kuadër të këtij restoranti.

Parcela në dy anët e saj përkufizohet me dy rrugë, po ashtu që rruga kryesore e cila të dërgon për fshatin O.. dhe fshatrat tjera gjendet në ballë të kësaj, kurse rruga tjetër e cila të shpije te restorant M. dhe shkolla e fshatit “Z. P.”, ndërsa dy anët e tjera të parcelës kufizohet me vet bazenin e liqenit ku akumulohet ujit.

Brenda vet parcelës është edhe një pjesë e mbjellë me drunjë pisha.

Parcela shtrihet përgjatë rrugës e cila të shpijë tek restorant M. si dhe te shkolla e fshatit, po ashtu e përfshin edhe një pjesë të rrugës kryesore që të shpije në O. dhe fshatrat tjera, ku në një pjesë të saj është edhe një objekt banimi në të cilin banon vet paditësi (kjo pjesë në të cilën shfrytëzohet nga paditësi shtrihet në ngastrën 1341-0 e cila tani është ndarë në njësinë-1 dhe-2).

Po ashtu, nga e gjithë kjo është vërtetuar se paditësi nuk është në posedim të paluajtshmërsë kontestuese, përveç pjesës së theksuar e për të cilën siç është konstatuar më lartë kjo çështje tani përbënë çështje të gjykuar.

Është jokontestues fakti për gjykatën se H. A. H. ish nga fshati O., Komuna Podujevë, tani i ndjeri-gjyshi i paditësit ka qenë pronar i ngastrave nr.../3, .../1 dhe .../12, të evidentuara në Fletën Poseduese nr.13, të Kadastrit përshkrues e cila nuk gjen zbatim që nga viti 1960.

Ky fakt është i pa kontestuar nga palët ndërgjygjëse dhe provat tjera materiale që gjenden në shkresat e lëndës.

Jo kontestuese është fakti se gjyshit të paditësit H. A. H. ish nga fshati O., Komuna e Podujevës, iu kanë eksproprijuar në tërësi ngastrat kontestuese nr.../3, .../1 dhe .../12 të evidentuar në Aktvendimin për përcaktimin e kompensimit për pronat e paluajtshme të shpronësuara nr-.../61 të datës 23.07.1961, për shfrytëzuesin e eksproprijimit Kombinativ për përpunimin dhe shfrytëzimin e linjtit të Kosovës në Prishtinë, bazuar në vendimin e Sekretariatit Rajonal për Financa nr.03-.../61, e të cilave dhe ju ka caktuar kompensimin për paluajtshmërinë e eksproprijuar në bazë të këtij vendimi.

Ky fakt është i pamohueshëm si nga palët ndërgjygjëse ashtu dhe nga provat materiale që gjinden në shkresat e lëndës.

Është jokontestuese fakti për gjykatën dhe palët se paditësi A. H., është shpallur trashëgimtar i vetëm i tani të ndjerit A. H. H. ish nga fshati O., Komuna e Podujevës, por kjo vërtetohet dhe me provat materiale dhe atë Aktvendimi i ish Gjykatës Komunale në Podujevë T.nr.107/2003 datë 29.08.2003.

Ndërsa, lidhur me thëniet e paditësit, i cili në padi, parashtresa dhe seancat e shqyrtimit gjyqësor, ku ndër të tjera ka deklaruar se: *“...nuk është kontestues se prona që është objekt shqyrtimi është eksproprijuar për nevojat e liqenit të B., përmes vendimit Nr.2478/61 datë 23.07.1961, mirëpo asnjëherë nuk është kompensuar e as që i është zëvendësuar me ndonjë pronë tjetër...”*, Gjykata bazuar në këtë fakt të deklaruar nga paditësi konstatoi se paditësi ose gjyshi i tij i ndjerë H. H., apo madje babai i tij A. H. (i cili siç shihet në Aktvendimin Nr.2478/61 të datës 23.07.1961 ka marrë pjesë në procesin e eksproprijimit dhe madje nuk e ka kundërshtuar të njëjtin) ka pasur mundësi që ta kontestoi këtë të fakt edhe në bazë të Ligjit mbi eksproprijimin nr.1978, në të cilin ligj palët e pakënaqura për pronat e eksproprijuara kanë pasur afatin e caktuar kohor për të paraqitur kërkesat e tyre dhe ankesat kundër vendimeve mbi eksproprijimin dhe atë sipas nenit 21 par.3, 4 dhe 5 të këtij ligji, ku ndër të tjera thuhet se: *“Nëse shfrytëzuesi i eksproprijimit dhe pronari i mëparshëm atë e kërkojnë së bashku anulohet vendimi i formës së prerë mbi eksproprijimin (par.3) i nenit 21.*

Vendimi në formë të prerë mbi eksproprijimin do të anulohet dhe në bazë të kërkesës së pronarit të mëparshëm të pasurisë së paluajtshme të eksproprijuar, nëse shfrytëzuesi i eksproprijimit në afatin prej 3 vitesh, ç’ prej se vendimi ka marrë formën të prerë nuk ka kryer sipas natyrës së objektit punimet të nevojshme në atë objekt apo paluajtshmëri (par.4).

Pasi të kalojnë dhjetë vjetë nga dita kur vendimi ka marrë formë të prerë mbi eksproprijimin nuk mund të paraqitet kërkesa për anulimin e vendimit”.

Po ashtu është kontestues fakti se a ka të drejtë pala paditëse-nipi i H. A. H., A. H., ti njihet e drejta e pronësisë në ngastrat e eksproprijuara e të papaguara sipas paditësit, ngastra të cilat tani evidentohen si ngastra me nr.-0,-0, e të evidentuara në regjistrat kadastral në Zyrën Kadastrale Komunale në Podujevë në emër të paditurës Komuna e Podujevës.

Kërkesë kjo e cila kundërshtohet e paditura Komuna e Podujevës duke deklaruar se kemi të bëjmë me çështje të gjykuar dhe se ngastrat kontestuese janë eksproprijuar dhe paguar në tërësi nga ana e KEK-ut, pra ju ka paguar në tërësi ajo sipërfaqe kontestuese.

Se në çfarë periudhe kohore, pala e cila pretendon një të drejtë pronësore në pronën shoqërore, mund ta kërkojë, këtë të drejtë e ka rregulluar në atë periudhë kohore edhe Ligji për punën e bashkuar të vitit 1976 nr.528 ku në nenin 268 të këtij ligji në mënyrë decisive është përcaktuar se: *“Në qoftë se sendi i paluajtshëm është bërë mjet shoqërorë pa bazë juridike, kthimi i tij mund të kërkojë brenda pesë (5) vjetësh duke filluar nga data e informimit por jo më vonë se brenda dhjetë (10) vjetësh etj.”*, që do të thotë se paditësi ka lëshuar afatin dhe për kërkesën për njohje të drejtës së pronësisë mbi këtë bazë.

Paditësi në bazë të deklaramit në seancën gjyqësore me datë 20.12.2023, dhe parashtresën e datës 10.01.2024, ndër të tjera ka deklaruar se : *“... vërtetimi i pronësisë i palës paditëse në parcelën lëndore në bazë të parashkrimit fitues... sipas Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore, numër 827, të datës 30 Janar 1980 (në vazhdim: LMTHJP), ligj ky i aplikueshëm në rastin konkret për shkak se raporti material juridik ka lindur gjatë kohës sa ky ligj ka qenë në fuqi, neni 3, paditësi gëzon të drejtën e njohjes së pronësisë pasi që i njëjti asnjëherë nuk është*

kompensuar... e që kjo e drejtë i jep paditësit të drejtën e kthimit të pronës, *sepse ka bazë juridike në bazë të arsyeve të cekura...*”.

Gjykata, bazuar në bazën juridike të cilën e ka precizuar paditësi, dhe ka kërkuar njohjen e të drejtës në pronësi konstatoi se në bazë të par.1 të nenit 20 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridike pronësore (Nr.827 datë 30 janar 1980), thuhet se: *“E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim”*, kurse par.2 të neni 20 të Ligjit thuhet se: *“E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetërorë në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj”*.

Nëse bazohemi në bazën juridike sipas vetë ligjit bazuar në nenin 28 par.2 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridike pronësore, ku është paraparë se: *“Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të paluajtshëm mbi të cilin tjetri e ka të drejtën e pronësisë, e fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej dhjetë vitesh, kurse mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin prej 20 vjetësh”*.

Kjo çështje tani është rregulluar dhe me dispozitat e nenit 40 par.1 lidhur me nenin 104 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, ligj ky i cili është në fuqi tani.

Sipas veprimit juridik, në rastin konkret nuk kemi asnjë veprim juridik që e vërteton të drejtën e pronësisë së paditësit në paluajtshmërinë kontestuese.

Dhe sipas trashëgimisë, për ta fituar të drejtën në bazë të kësaj baze, paluajtshmëria kontestuese duhet të jetë në emër të paraardhësit të paditësit e që në rastin konkret kjo paluajtshmëri kontestuese evidentohet në emër të të paditurës.

Po ashtu, e paditura është e regjistruar si pronar në bazë të ligjit, meqë siç u konstatua më lartë prona kontestuese është ekspropriuar në bazë të procedurave të zhvilluara nga organi kompetent siç shihet dhe nga Aktvendim Nr. 2478/61 të datës 23.07.1961.

Prandaj, në asnjërin nga bazat e lartpërmendura paditësi nuk e ka arsyetuar se ka bazë juridike për njohjen e të drejtës së pronësisë bazuar në nenin 20 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridike pronësore.

Sa i përket të drejtës me parashkrim dhe posedim, paditësi kur ka filluar ta shfrytëzoj paluajtshmërinë kontestuese të cilën në pjesën më të madhe nuk e ka pasur dhe nuk e ka në posedim dhe shfrytëzim e për të cilën u konstatua se kemi të bëjmë me çështje të gjykuar (sa i përket pjesës të cilën e ka në posedim), ka pas njohuri se paluajtshmërinë që e posedon është pronë e cila evidentohet në emër të të paditurës, e cila paluajtshmëri me aktvendimin mbi eksproprijim evidentohet si paluajtshmëri në emër të Komunës së Podujevës këtu e paditura.

Po ashtu edhe mbajtja nuk është me mirëbesim sepse ajo me Aktvendimin mbi eksproprijim të organit kompetent ka kaluar në emër të Komunës së Podujevës e sipas nenit 20 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridike pronësore par.2 e këtë të drejtë nuk e ka fituar paditësi por as me par.1 të nenit 20.

Gjithashtu dhe me dispozitën nga neni 29 par.1 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridike pronësore, në mënyrë decisive është përcaktuar se: *“mbi sendin në pronësinë shoqërore e drejta e pronësisë nuk mund të fitohet me parashkrim fitues”*.

Atëherë, gjykatës nuk i mbeti tjetër veçse kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoi si të pa bazuar dhe pa argumentuar, në mungesë të bazës ligjore, e këtë më së miri e dëshmon dhe mungesa e provave për ti paraqitur nga ana e palës paditëse dhe bazës ligjore edhe pse e ka pasur për obligim që t’ia paraqes ato gjykatës sipas nenit 7.1 të LPK-së, në të cilin është paraparë se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”*, lidhur me nenin 319 par.1 dhe 2 të LPK-së, ku është përcaktuar se: *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta., respektivisht “Të provuarit përfshihen në të gjitha faktet që janë të rëndësishme për dhënien e vendimit.”*, por ai nuk e bëri këtë dhe nuk mundi të bëjë të bazuar dhe të besuar me argumente dhe prova konkrete kërkesën e tij në mënyrë që të aprovohet nga gjykata.

Prandaj, në mungesë të provave të paraqitura nga pala paditëse për vërtetimin e bazës juridike të kërkesës së tij dhe në mungesë të bazës ligjore, atëherë gjykata vlerësoi se nuk mundet dhe nuk i mbetet asgjë tjetër vetëm se ta refuzoj kërkesëpadinë si të pa bazuar në tërësi, në mungesë të provave dhe në veçanti në mungesë të bazës ligjore.

Gjykata me rastin e vendosjes shqyrtoi dhe vlerësoi edhe provat tjera për palën paditëse dhe kundërshtimet e të paditurës si dhe provat tjera të administruara që gjenden në shkresat e lëndës, mirëpo vlerësoi se të njëjtat nuk mund të ndikojnë në vendimin përfundimtar ndryshe të çështjes së ngritur me padi, nga siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi që secila palë t’i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 449 dhe 450 të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.355/2016, me datën 10.01.2024**

Gjyqtari:
Nazmi Neziri

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.